



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

FINANÇAT PËR TË RINJTË



ÇFARË DUHET TË DINI MBI
MENAXHIMIN E FINANCAVE
PERSONALE

PËRMBAJTJA

1. **HYRJE**
2. **ÇKA NDIKON NË SJELLJET DHE VENDIMET FINANCIARE TË INDIVIDIT?**
3. **CILI ËSHTË BUXHETI JUAJ PËR SHPENZIME?**
4. **KU SHKOJNË/SHPENZOHEN PARATË?**
5. **PLANIFIKIMI I FINANCIVE PERSONALE/ BUXHETIMI**
6. **QËLLIMET FINANCIARE**
7. **SHEMBULL:PËRGATITJA E BUXHETIT**
8. **DISA KËSHILLA QË DO T'JU NDIHMOJNË NË MENAXHIMIN E FINANCIVE PERSONALE**
9. **RAPORTI ME BANKAT (LLOGARIA BANKARE)**
10. **KARTELAT BANKARE**
11. **KREDIA**
12. **HISTORIA E KREDISË**

HYRJE

Përmes kësaj broshure synojmë të nxitim tek të rinjtë zhvillimin e aftësive për menaxhimin e parasë, pasi që njëra nga aftësitë esenciale të jetës është aftësia e menaxhimit të financave (parave) personale.

Përderisa të hyrat financiare janë të limituara, të rinjtë duhet të jenë të përgatitur që t'i menaxhojnë mirë ato dhe duhet të mësojnë të jenë të pavarur dhe sa më pak të ndikuar nga ndonjë krizë e mundshme financiare.

Sa më shumë njohuri të kemi rreth menaxhimit të financave personale, aq më pak probleme do të kemi dhe do të jemi më të përgatitur t'iu bëjme ballë problemeve financiare, me sukses.

Çka ndikon në sjelljet dhe vendimet financiare të individit?

Çdo ditë përballemi me vendime të ndryshme rreth shpenzimeve, qofshin ato shpenzime të thjeshta ditore (për furnizim me gjëra ushqimore) e po ashtu edhe planifikime më afatgjatë (sa para mund të shpenzoj për pushim veror?) etj. Sa më të kujdesshëm të jemi në menaxhimin e parave aq më pak shqetësime do të kemi.



Pikëpamjet personale, por edhe pikëpamjet e anëtarëve tjerë të familjes dhe miqve shpesh e përcaktojnë sjelljen tonë ndaj parasë.

Menaxhimi i duhur i parave është i rëndësishëm për individin, për familjen dhe shoqërinë.

Prandaj është e rëndësishme të mësojmë të menaxhojmë paratë, në mënyrë që paratë të mos na menaxhojnë ne, dhe ky është një mësim që duhet ta përsosim gjatë gjithë jetës.



Në menaxhimin e parave tona, ne ndikohemi nga faktorët:

- **ekonomik** (të ardhurat, çmimet, krizat, etj);
- **social** (rrethi, familja, miqtë, etj);
- **psikologjik** (ndjenjat, qëndrimet, etj).

- Çfarë është e rëndësishme për mua?
- Si jam mësuar të bëj diçka?
- Si ndikojnë tek unë preferencat dhe vendimet e familjes?
- Sa mund të fitoj ose të humbas?



Cili është buxheti juaj për shpenzime?

Para se të bëni shpenzime të mëdha duhet të dini se:

- Jo të gjitha të hyrat tuaja bruto janë të hyrat të cilat janë në dispozicion për shpenzim. Cila është shuma e të ardhurave që mbeten pas zbritjeve të shpenzimeve të detyrueshme (p.sh. tatimet dhe kontributi pensional).
- Të ardhurat e disponueshme janë paratë që mbeten pas pagimit të shpenzimeve të detyrueshme.

Shpenzimet e detyrueshme janë shpenzimet që duhet të bëjë një individ, një biznes ose një organizatë në mënyrë të rregullt dhe në përputhje me ligjet dhe rregulloret. Këto shpenzime mund të jenë të ndryshme në varësi të kontekstit dhe karakteristikave të subjektit që i bën ato.

Disa nga shembujt e shpenzimeve të detyrueshme janë:

- Tatime mbi pagë, të ardhurat nga biznesi, taksat e pronës dhe taksat mbi mallrat dhe shërbimet;
- Pagesat e faturave për energjinë elektrike, ujin dhe mbeturina.

Përfshini kursimet tuaja në "shpenzime fikse" në mënyrë që të arrini qëllimin tuaj financiar.




Ku shkojnë/shpenzohen paratë?

Shpenzimet ndahen në dy kategori themelore:

Shpenzime fikse - janë shpenzimet e domosdoshme të cilat nuk mund të shmangen. Disa nga shpenzimet fikse janë: tatimet dhe kontributet, qiraja, sigurimi, kësti i kredisë, transporti, pagesa e semestrit, etj.

Të ndryshueshme - shpenzimet që mund të ndryshojnë (p.sh. shpenzimet e ushqimit, veshjes, argëtimit, etj).




Shpenzimet fikse - janë shpenzimet e domosdoshme të cilat nuk mund të shmangen.

Disa nga shpenzimet fikse janë: tatimet dhe kontributet, qiraja, sigurimi, kësti i kredisë, shpenzimet e shtëpisë.

Shembull:

Shpenzimet- Mars 2023			
Të hyrat totale mujore	shuma	Shpenzimet fikse mujore	shuma
Paga mujore- si student	450 €	tatimi në pagë (paga bazë 450 €)	21 €
Të hyrat nga bursa e fituar në universitet	100 €	kontributi pensional (5 % e pagës)	22.50 €
Totali	550 €	ushqim	200€
		telefoni + interneti	25 €
		transporti	20 €
		Kursimet	100 €
		Totali i paraparë i shpenzimeve fikse	388.5 €



Shpenzimet e ndryshueshme- janë shpenzimet që ne i bëjmë për t'i plotësuar nevojat dhe dëshirat e përditshme dhe mund të ndryshojnë si: ushqimi, veshmbathja, argëtimi etj.

Shembull:

Shpenzimet- Mars 2023	
Shpenzimet e ndryshueshme	shuma
Kursi për media sociale	80€
argëtim/kinema/teater	20 €
librat	25 €
veshmbathje	20 €
të tjera	16.5 €
Totali i paraparë i shpenzimeve të ndryshueshme	161.5€

Planifikimi i financave personale- buxhetimi

Për një menaxhim të mirë dhe të suksesshëm të parave, nevojitet një plan financiar i qartë dhe konkret.

Krijoni modelin e shpenzimeve dhe kursimeve tuaja duke u bazuar në objektivat tuaja. Sa më i mirë të jetë modeli që ju keni ndërtuar për shpenzimet dhe kursimet tuaja aq më lehtë do ta keni ta përcjellni sjelljen tuaj, si dhe ta ndryshoni nëse është e nevojshme.

Procesi i planifikimit financiar mund të ndahet në tre hapa themelorë:

1. **Vlerësimi** i situatës financiare aktuale;
2. **Përcaktimi i qëllimeve** financiare dhe krijimi i një plani financiar;
3. **Kontrollimi** i zbatimit të planit financiar.

Hapi i 1-rë: vlerësimi i situatës financiare aktuale -

Para se të filloni procesin e planifikimit financiar, është e rëndësishme që ju të dini se si të vlerësoni gjendjen tuaj aktuale financiare, ose cilat janë mundësitë tuaja për të arritur një qëllim financiar.

Kjo është e rëndësishme në mënyrë që të keni të qartë sa para keni dhe sa shpenzoni, nga vijnë paratë tuaja dhe ku shkojnë.



Hapi i 2-të: Përcaktimi i qëllimeve financiare dhe krijimi i një plani financiar

Në mënyrë që të menaxhojmë me sukses financat personale dhe të përdorim me maturi paratë tona, duhet të hartojmë një plan financiar. Krijimi i një plani financiar fillon me vendosjen e qëllimeve financiare që duam të arrijmë, duke lehtësuar kështu procesin e vendimmarrjes.

Qëllimet financiare janë shndërrimet e dëshirave tuaja në qëllime.

Për të realizuar dëshirat tuaja së pari duhet vendosur në letër për të parë se sa të arritshme janë ato.

Cili është qëllimi jua financiar, sa kushton arritja e dëshirave tuaja, si dhe koha e nevojshme?

Cila është sakrifica financiare që duhet të bëni dhe sa duhet të kurseni në muaj?



Qëllimet ndahen në :

Qëllime afatshkurtra janë ato të cilat mendojmë t'i përbushim në një periudhë prej një muaji;

Qëllimet afatmesme mund të përbushen brenda një muaji deri në një vit;

Qëllimet afatgjata mund të arrihen në një periudhë më të gjatë se një vit.



Çdo qëllim duhet të jetë i përcaktuar (p.sh. të blesh një biletë për kinema, një libër ose laptop);

i matshëm (paratë që nevojiten për përmbushjen e një qëllimi;

i arritshëm (përpjekjet dhe veprimet që duhet të ndërmerren për të arritur qëllimin, p.sh. kurseni 10 Euro në muaj duke shpenzuar më pak për kafe dhe pije, në mënyrë që të mund të shpenzoni më shumë për libra ose kinema);

dhe

me **një afat kohor** (brenda të cilit synojmë ta arrijmë qëllimin e caktuar, varësisht nëse ai është **qëllim afatshkurtër, afatmesëm ose afatgjatë** (p.sh. 7 ditë, 3 muaj ose 2 vjet).

Qëllimet e mia financiare	shuma	pas sa muajsh dëshironi ta arrini qëllimin	kursimet mujore të nevojshme
blerja e një laptopi	200 €	3 muaj	66.66 €
shëtitje-eurotrip	600 €	12 muaj	50 €


Nëse pas llogaritjes e kuptoni se do ta keni vështirë ta paguani laptopin e ri deri sa nuk e paguani edhe këstin e fundit për telefon mobil të cilin e keni blerë vitin e kaluar, atëherë qëllimi juaj nga një qëllim afatshkurtër do të shndërrohet në afatmesëm. Prandaj është e rëndësishme të mos tejkaloni kapacitetet tuaja sepse atëherë do të përballeni me vështirësi financiare.



Hapi i 3-të: Kontrollimi i zbatimit të planit financiar

Kontrollimi i zbatimit të planit financiar është hapi i fundit në planifikimin financiar dhe nënkupton rishikimin e të gjithë hapave paraprak për të arritur në përfundim nëse kemi vepruar siç kemi planifikuar.

Rishikimi i planit financiar do të duhej të bëhej të paktën një herë në vit, për t'u siguruar se po përparojmë drejt arritjes së qëllimeve tona, në periudha të caktuara të jetës.



Planifikimin financiar nuk duhet shikuar si një proces që përfundon me arritjen e një qëllimi të caktuar, por si një proces dinamik dhe i vazhdueshëm.

Prandaj, arritja e një qëllimi mund të konsiderohet si një pikënisje për përcaktimin dhe realizimin e një qëllimi të ri.



Planifikimi i buxhetit - fillimisht duhet përcaktuar periudhën për të cilën planifikohet buxheti, e pastaj të përcaktojmë nivelin e të hyrave dhe shpenzimeve.

Plani financiar- Mars 2023	
Totali i paraparë i shpenzimeve fikse	388.5 €
+	
Totali i paraparë i shpenzimeve të ndryshueshme	161.5€
=	
Të hyrat totale mujore	550 €

Për të planifikuar me sukses buxhetin personal, është e rëndësishme të jemi të informuar dhe të vëmendshëm sepse vetëm kështu do t'i menaxhojmë me sukses financat personale.



Disa këshilla që do t'ju ndihmojnë në menaxhimin e financave personale

- Para çdo blerje bëni dallimin midis dëshirave dhe nevojave.
- Secili njeri ka vlerësimet/ qëndrimet personale rreth gjërave që i konsideron të nevojshme dhe të dëshirueshme.
- Përpiquni të mos ndikoheni nga preferencat e të tjerëve.
- Pikëpamjet e ndryshme rezultojnë në nevoja dhe dëshira të ndryshme të një personi, dhe si rrjedhojë edhe në marrjen e vendimeve të ndryshme financiare, përmes të cilave përpiqemi të arrijmë qëllimet tona të cilat janë të rëndësishme për ne.



P.sh. Ju e konsideroni si vlerë kryerjen e një kursi dizajni, ndërsa shoqja juaj një kurs për mësimin e një gjuhe të huaj, prandaj edhe kursimet tuaja ia dedikoni qëllimeve të ndryshme.



Blerjet impulsive

Emocionet dhe paratë janë mjaft të ndërlidhura sepse emocionet kanë shumë ndikim në mënyrën se si ne shpenzojmë.

Shpenzimet emocionale – janë shpenzimet/blerjet impulsive të ndikuara nga gjendja emocionale.



Blerja impulsive e një çokollate apo ëmbëlsire, apo qerasja e shokëve pas një dite të lodhshme nuk paraqet problem. Situata bëhet shqetësuese nëse përfundojmë duke bërë një shpenzim i cili tejkalon mundësitë tona, prandaj për ta shmangur këtë është e rëndësishme që gjithmonë të kemi vetëkontroll edhe në situata emocionuese sepse emocionet ndikojnë në blerjet impulsive.

**Konsumoni me përgjegjshmëri!
Shmangni blerjet impulsive!**



RAPORTI ME BANKAT

Herët apo vonë ju do të duhet të përdorni llogarinë bankare dhe sa më të informuar të jeni, aq më të lehtë do ta keni të krijoni komunikimin dhe ndertimin e marrëdhënieve me bankën tuaj.

Përse ju nevojitet një llogari bankare?

1. Që të ruani paratë tuaja nga humbja, vjedhja, djegia;
2. Mund të pranoni depozita, ta merrni pagën tuaj mujore;
3. Të kryeni pagesa të ndryshme dhe nuk keni nevojë të paguani për gjithçka në para të gatshme, mund të paguani faturat nga llogaria juaj e kontrolluar.
4. P.sh: të bëni pagesat për studime
 - Të kontrolloni shpenzimet tuaja kurdo që keni nevojë.



Ja se çfarë duhet të dini rreth zgjedhjes së bankës tuaj të parë dhe hapjes së llogarisë tuaj bankare.

Varësisht se çfarë shërbime dëshironi, ju mund të zgjedhni llojin e llogarisë bankare që ju përshtatet më së shumti nevojave tuaja. Ju rekomandojmë të shikoni web faqet zyrtare të bankave komerciale për të parë llojet e llogarive dhe produkteve që ato ofrojnë, tarifat të cilat i ofrojnë për shërbimet që juve ju nevojiten dhe qasjen që ju ofrojnë në këto produkte apo shërbime.

Disa lloje të llogarive të aplikueshme në Kosovë janë: llogaria rrjedhëse, llogaria e kursimeve, llogaria studentore, llogaria e kursimeve për fëmijë, llogaria fleksibile...etj.

Llogaria rrjedhëse - mund të hapet nga një person fizik ose person juridik (shoqeri/korporatë).

- Shikoni tarifat e produkteve dhe shërbimeve;
- Shikoni a mund të kryeni pagesa automatike;
- Shikoni nëse kartelat janë të pranueshme në vendet ku ju udhëtoni;
- Përmes aplikacionit në telefon mund të kontrolloni shpenzimet tuaja apo të kryeni pagesa;
- Nuk keni nevojë të mbani të hollat tuaja kesh (para të gatshme), i depononi ato në llogarinë tuaj dhe mund t'i tërhiqni pjesë pjesë nga ATM (bankomati).



Llogari kursimi - nëse planifikoni të kurseni si dhe nëse synoni që paratë tuaja t'i ktheni në një investim.

- Shikoni tarifat e shërbimeve.
- Interesin që mund të fitoni nga depozitat tuaja në bankë.
- Depozitoni dhe tërhiqni para në bankë.
- Përmes urdhëresës automatike ju mund të kurseni një shumë të caktuar pa pasur nevojë të shkoni në bankë.



Përveç llogarive dhe depozitave, bankat ofrojnë edhe financime të ndryshme siç janë Kreditë.



Kredia- është marrje e huasë (një shumë të hollash) nga banka apo institucioni financiar, e cila do t'i kthehet bankës më vonë me interes dhe kushte të caktuara.

Kredia ju mundëson të bëni blerje të ndryshme me paratë që ju nuk i keni sot, por kredia lidhet gjithsesi me të hyrat që do t'i merrni në të ardhmen pasi që huazimin që merrni sot do ta paguani me të hyrat që do t'i merrni në të ardhmen.

*****MOS HUAZONI ATË QË NUK
MUND TA KTHENI***
KENI KUJDES ME HUAZIMIN E TË
HOLLAVE PASI QË HUAZIMI MUND
TË JETË I DËMSHËM PËR JU.**



- Marrja e kredisë do të ju pengojë që të kurseni në të ardhmen pasi që do t'iu duhet që gjithmonë të ndani një shumë nga të hyrat tuaja për të kthyer kredinë dhe me këtë do të mbeten më pak të holla për t'i kursyer.
- Marrja e kredisë kushton, sepse do t'iu duhet të paguani interes si dhe shpenzime tjera administrative të bankës.
- Mospagesa e kredisë mund të dërgojë në konfiskim të pronës tuaj.



KARTELAT BANKARE

Kartelat bankare janë instrument pagese, të cilat janë krijuar për të eliminuar nevojën e përdorimit të parasë së gatshme. Ato mundësojnë pagesat për mallrat apo shërbimet e blera, si dhe tërheqjen e parasë së gatshme sipas nevojës, në terminale të caktuara.

Kemi dy lloje të kartelave: **Debit Kartela** dhe **Kredit Kartela**.



KREDIT KARTELA


- Huazoni para nga banka për të kryer blerje të ndryshme (formë kredie).
- Jeni përgjegjës për kthimin e huasë për blerjet që keni bërë me këtë kartelë.
- Mund të shpenzoni më shumë se sa keni.
- Mund të tërhiqni para nga ATM/bankomati por mund t'iu duhet të paguani tarifë shtesë.
- Paguani penalti/ ndëshkime, kamata për vonesa, kamata për mbitërheqje).
- Paguani interes për pagesat minimale.
- Mund të ndikoj në raportin tuaj kreditor.

DEBIT KARTELA

- Mund të paguani për blerje të ndryshme direkt nga llogaria juaj bankare.
- Ju nuk mund të shpenzoni më shumë se sa keni mjete në llogari.
- Mund të tërhiqni para të gatshme nga ATM/ bankomati.
- Nuk ka ndikim në raportin tuaj kreditor.

Kredit Kartela (Përdorimi i kredit kartelës)

- Duhet të dini se edhe kredit kartela është një formë kredie.
- Para se të vendosni për marrjen e kredit kartelës duhet të jeni në dijeni për ngarkesat financiare të përdorimit/mbajtjes së kredit kartelës.
- Bëni krahasimin midis kartelave që ofrohen nga të gjitha bankat në vend.
- Te shpenzimet totale të kartelës, përfshini shpenzimet e interesit dhe tarifatat (si tarifa e shërbimit, tarifatat ndëshkuese, kamatat).
- Normat vjetore, kostoja e kredit kartelës në baza vjetore.



Cilat janë kurthet e kredit kartelës?

- Promovimi i normave motivuese (psh. fitimi i bonuseve në rast se bëhet blerje me kredit kartelë) për të bërë sa më shumë blerje me kredit kartelë, por nëse ju nuk jeni të vëmendshëm mund t'iu shkaktojë probleme me financat.
- Penalti/ndëshkime, kamata për vonesa, kamata për mbitërheqje).
- Interesi për pagesa minimale.

Shenjat paralajmëruese se keni problem me huanë:

- ▶ Keni problem dhe nuk arrini ta paguani as edhe shumën minimale për shkak se bilanci total i kredisë vazhdon të rritet çdo muaj.
- ▶ Humbja e pagesës së këstit të kredisë ose pagesa me vonesë.
- ▶ Përdorni kursimet për të paguar për shpenzimet elementare.
- ▶ Marrja e njoftimeve të njëpasnjëshme nga banka, për të kryer pagesën e këstit.
- ▶ Huazoni para për të paguar borxhin e vjetër.
- ▶ Tejkalimi i limitit të kredit kartelës tuaj.



HISTORIA E KREDISË

**** E kaluara e kredisë është e ardhmja juaj e kredisë - Regjistri i kredive mban të gjitha të dhënat tuaja në lidhje me shlyerjen e kredisë. Personat me rezultat të ulët të kredisë paguajnë më shumë për të marrë kredi në të ardhmen.**

- Informacioni mbi shlyerjen e kredisë qëndron në regjistër të kredisë për 5 deri në 7 vite, varësisht nga kategoria në të cilën jeni të vendosur.

Bazuar në Nenin 16 të Udhëzimit të Bankës Qendrore për Regjistrin e Kredive, të dhënat kreditore për kreditë e klasifikuara në kategoritë "B", "C", "D" dhe "E" do të ruhen në regjistrin e kredive deri në (5) vite nga data e fundit e shlyerjes së kredisë, ndërsa për kreditë e klasifikuara në kategorinë "W" të dhënat kreditore do të ruhen deri në (7) vite pas përditësimit të fundit me shumën e mbetur zero d.m.th. nga data e fundit e shlyerjes së kredisë dhe jo nga data kur është marrë kredia.





**Këtë publikim mund ta gjeni edhe në formë elektronike në adresën:
www.edukimifinanciar.org**





Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Departamenti për Marrëdhënie me Jashtë
www.bqk-kos.org

